



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 104
Prishtinë, më 1 prill 2010

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 1 PRILL 2010

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 91 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Ai njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetari propozoi që pika e pestë - Ratifikimi i Marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main, të radhitet si pikë e parë.

Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,

2. Ratifikimi i Marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i tretë i Projektligjit për masat antidamping,
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës,
6. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion për Propozim - Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 4, 11 dhe 18 mars 2010

Procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 4, 11 dhe 18 mars 2010, u miratuan pa vërejtje.

2. Ratifikimi i Marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Marrëveshjen për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qendrore Gjermane dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ai ftoi ministrin Ahmet Shala, në emër të propozuesit, për ta arsyetuar ratifikimin e marrëveshjes.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, Ahmet Shala, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar grande nga Qeveria e Republikës Gjermane në shumën prej 16,5 milionë euro dhe kredi të butë prej 17 milionë euro. Mjetet janë afruar përmes Bankës Gjermane për zhvillim, që quhet KfW, përkatësisht KfWW. Ky financim ka për qëllim ndërtimin e linjës 400 kilovoltshëshe Prishtinë – Tiranë, që është rreth 240 kilometra e gjatë dhe pjesa për Kosovën është rreth 35 kilometra e gjatë.

Kjo kredi dhe pjesa e grandit do të na ndihmojnë në përmirësimin e parakushteve për krijimin e një tregu të integruar të energjisë me Evropën Juglindore.

Afati i shlyerjes së kredisë është 15 vjet, për 3 vjet grejs periodë dhe me kushte të mira, përkatësisht kamata shumë të ulëta. Ripagesa e kredisë është në 24 kështe çdo gjysmëvjetor në mënyrë proporcionale dhe të barabartë. Interesi për kredinë do të paguhet në shkallën e përcaktuar nga KfW-ja dhe do të jetë 5,34% .

Duke marrë parasysh nevojën për ngritjen dhe zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë, përmirësimin dhe integrimin e sistemit të transmisionit përmes linjës 400 kilovoltshëshe Prishtinë – Shqipëri, për dobinë që do të kemi ne si shtet, si dhe kushtet shumë të volitshme të financimit, besoj se ky ratifikim do të ndihmojë zhvillimin e sektorit energjetik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë marrëveshje dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Etem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Eset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxheri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Petar Miletqi dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq, si dhe deputetët: Armend Zemaj, Ibrahim Makolli dhe Naser Rugova, që janë dhanë në transkript.

Kryetari hodhi në votim ratifikimin e Marrëveshjes. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----91,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Ratifikohet Marrëveshja për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main.
2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është teksti i Marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW Frankfurt am Main.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Driton Tali, i parashtrroi pyetje ministres së Energjisë dhe të Minierave, Justina Pula Shiroka, lidhur Kompaninë për Distribucion dhe Furnizim të Energjisë Elektrike, KKDFE.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti Riza Smaka, i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, lidhur me procedurat për aplikim për viza të Shëngenit për qytetarët e Kosovës në ambasadat e vendeve të huaja, të akredituara në Prishtinë.

Ministri Hyseni iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti Riza Smaka, i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashi, lidhur me trajtimin e barabartë të familjeve skamnore me rastin e dhënies së ndihmës materiale.

Ministri Rashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja Nurisha Hula, i parashtroi pyetje ministres së Energjisë dhe të Minierave, Justina Pula Shiroka, lidhur me rritjen e çmimit të energjisë elektrike prej muajit prill 2010.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Hula.

Deputeti Driton Tali, i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me operatorin e telefonisë mobile “Dardafon”.

Ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja Gjylnaze Sylaj, i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me evidencimin e dëmeve të luftës që i ka shkaktuar Serbia Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylaj.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, lidhur me marrëveshjen me Qeverinë për realizimin e Projektit për kanalizim dhe trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Deçanit.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputeti Ibrahim Selmanaj, i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me saktësinë e të dhënave në media për ndërtimin e shtëpisë së tij private në lagjen e Veternikut.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Selmanaj.

Deputetja Gjylnaze Sylaj, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me ndërtimin e Shkollë së Mesme të Muzikës në Prishtinë.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylaj.

Deputeti Naim Rustemi, i parashtroi pyetje ministres së Energjisë dhe të Minierave, Justina Pula Shiroka, lidhur me operimin e EPS (Elektro Privreda Serbije) në Kosovë.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-097 për masat antidamping

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit për procedurën e shqyrtimit të Projektligjit për masat antidamping, si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të komisionit funksional për këtë projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion. Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet, pre1 deri në 67.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 03/L-097 për masat antidamping.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që në emër të propozuesit ta arsyetojë Propozim-vendimin.

Fatmir Limaj tha se themelimin e Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës e parasheh Ligji për hekurudhat. Ai në vazhdim vlerësoi shumë të çmueshme ndihmën e Komisionit Evropian, si pjesë e pandashme e hekurudhave të Kosovës. Ministri tha se gjendja në trafikun hekurudhor është në nivelin jo shumë të knaqshëm, andaj kompletimi i Bordit në fjalë do të ndihmonte në krijimin e kushteve dhe të rregullave të cilat do të ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja në këtë fushë të trafikut. Në fund, ai kërkoi miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë nga ana e Kuvendit, në mënyrë që sa më shpejt të fillojë funksionalizimi i këtij sektori.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, si dhe deputetët: Riza Smaka, Naim Rustemi, Eqrem Kryeziu, Vezira Emrush, Fatmir Rexhepi, Driton Tali, Synavere Rysha, Naim Maloku, Fatmir Limaj, kryeministri Hashim Thaçi, Ahmet Isufi, Gani Koci, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,

Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës

I. Anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës emërohen:

1. Halit Gara,
2. Gëzim Qerimi,
3. Ilmi Ahmeti

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, për Strategjinë e energjisë 2009-2018

Strategjia e energjisë për periudhën 2009-2018 ishte shqyrtuar në seancën e mbajtur më 18 mars 2010, por kishin mbetur për t'u votuar rekomandimet e komisionit funksional për seancën e sotme.

Kryetari ftoi kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për t'i arsyetuar rekomandimet e komisionit.

Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, Myzejene Selmani, paraqiti pesë (5) rekomandime për plotësimin e Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Strategjinë e energjisë 2009-2018 dhanë edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ministrat Justina Shiroka –Pula dhe Ahmet Shala, si dhe deputetët: Berim Ramosaj, Et'hem Çeku, Heset Cakolli dhe Lulzim Zeneli, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Propozim – strategjinë e energjisë 2009 – 2018 me plotësimin e rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----6,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Strategjia e Energjisë për periudhën 2009-2018, me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si në vijim:

1. Resurset e linjitit të vihen në dispozicion dhe shfrytëzim në pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës.
2. Të krijohet ambient ligjor për konkurrencë dhe treg të lirë në fushën e sektorit të energjisë.
3. Në Strategjinë e energjisë, seksioni 11.2.5 Rivitalizimi i TC “Kosova B” me pjesëmarrjen e sektorit privat, ndryshohet fjalia e tretë e paragrafit të dytë dhe formulohet si vijon: “sektori privat do të përfshihet në kuadër të transaksionit “Kosova e Re”.
4. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovën, në fazën e parë kapaciteti 1000 megavat me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera, në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit dhe të rajonit.
5. Qeveria e Kosovës obligohet ta harmonizojë Planin e veprimit me Strategjinë e energjisë të miratuar për periudhën 2009-2018.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale